



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7259/2021
Data: 21.09.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e tetë -VIII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.08.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se znj. Zirafete Axhami dhe z. Florim Shkreta në pamundësi për pjesëmarrje në mënyrë fizike ju ka mundur që përmes sistemit elektronik zoom pjesëmarrja në mbledhje.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2021.
4. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.
5. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
6. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2020.
7. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020-2021.
8. Informatë për korrje shirjet.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- në muajin gusht ka rritje të rasteve edhe pse kemi mungesë të stafit janë duke u zhvilluar punët mirë. Gjatë javës së kaluar janë kryer 163 testime dhe prej tyre 72 pozitiv dhe 91 negativ. Në total janë kryer 570 testime dhe prej tyre 180 pozitivë dhe 390 negativ. Aktualisht kemi 110 raste aktive pozitiv dhe 70 të shëruar. Është duke vazhduar puna edhe me ekipet vaksinimit vetëm me një orar për shkak të mungesës së mjekëve. Nga fillimi e deri më tani janë dhënë 3713 vaksina dhe prej tyre 2664 janë ata të cilët e kanë marr dozën e parë dhe 1049 janë ata të cilët janë vaksinuar me nga dy doza. Nga komiteti për imunizim jemi njoftuar se nuk guxojmë ta vaksinojmë pa termin.

Mefail Suma thekson:- vitin e kaluar isha me Kovid dhe kur më është dhënë ndihma e parë bombola e oksigjenit kanë qenë shumë të vogla dhe asnjëra nuk ka qenë funksionale për me furnizuar me oksigjen. Me sa jam informuar është një dhomë që trajtohen pacientët me kovid, a keni dërguar bombola të mëdha të oksigjenit për shkak se nëse shkon në ambulanca të tjera është e vendosur bombola edhe te krevati dhe pajisjet e tjera për oksigjen. Vitin e kaluar kam shkuar pa përcjellje dhe a ka mundësi që në autoambulancë me vendosur një bombol të oksigjenit me pajisjet përcjellëse.

Mehmet Ballazhi thekson:- flitet në opinion për rasti fundit që ka ndodhur për shkak të bombolës së oksigjenit që nuk ka pasur mjaftueshëm.

Sabedin Hasallari thekson:- personave të cilët vaksinohen a ju bëhet testi para se me marr vaksinën. Si bëhet furnizimi i QKMF-së me vaksina në baza javore apo mujore. Kërkoj që edhe ditën e shtunë të vazhdohet me vaksinim për shkak se interesimit i qytetarëve është shumë më i madh se në muajt e kaluar.

Sead Vila thekson:- në muajin korrik dhe gusht i kam marr vaksinat dhe vërejtje kam te stafi se nëse kanë qenë listat prirotare do të ishte mirë për ato kategori e nëse kanë bërë përjashtime ne të bëhen edhe për raste të tjera sepse kam pasur rast se disa individ nuk kanë qenë në listën prioritare por kanë depërtuar e disa tjerë nuk kanë mundur. Komunikimi që kam hasur ndaj meje por edhe ndaj një pacienti tjetër nga një punonjës aty nuk më ka pëlqyer dhe kjo nuk do të thotë që mundet me zbehë punën e drejtorisë apo të punëtorëve aty por megjithatë kam vërejtur që ka edhe individ që nuk kanë sjellje të mira aty por do të ishte mirë me pasur një komunikim të mirë me gjithë pacientët.

Sabrije Krasniçi thekson:- kërkoj sqarim për vaksinimin te gratë shtatzëna dhe gjdhënëse.

Isni Bushi thekson:-sa i përket rritjes së numrit të pacientëve me kovid a vërehet që ka filluar vetëdijesimi i qytetarëve apo vërehet ndonjë fluks më i madh që dëshirojnë me u vaksinuar

Medina Imishti thekson:- sa i përket bombolave të oksigjenit te pjesa e kovidit është obligative që çdo shtrat me pasur edhe oksigjeno terapinë. Gjatë vizitës në QKMF e di që çdo shtrat e ka pasur oksigjeno terapinë për trajtim nëse ka qenë rast me kovid, mirëpo në rast se nuk janë do ta diskutoj me drejtorin që çdo shtarët me pasur pjesën e oksigjeno terapisë. Veturat e ndihmës së shpejtë janë të obliguara me pasur bombola të oksigjenit po tërë kohën i kemi dhënë edhe për pacientë për shfrytëzim edhe pse nuk ka qenë obligim i komunës. Për në atuambulancë nuk kam pasur ndonjë vërejtje prej pacientëve. Pas përfundimit të mbledhjes së kuvendit do të merrem me të gjitha vërejtjet të cilat u potencuan. Informacione nuk kam pasur për vërejtjet të cilat u parashtruar për shkak se ankesa nuk kam me shkrim prej asnjë pacienti dhe prej stafit sepse kur ata shpenzohen stafi parashtron kërkesë me një herë për mbushje. Testimet para vaksinimit nuk janë obligative por vetëm në rastet kur i referohet nga mjeku dhe pacienti testohet dhe vaksinohet. Sa i përket vaksinimit vazhdimisht kemi bërë kërkesa për me na u lejuar edhe një specializantë që me punuar edhe në orarin e pasdites në mënyrë që me vazhduar punën e vaksinimit deri në ora tërë. Ministria të obligonë me punuar edhe të shtuneve ndërsa të obligonë me i liruar prej punës gratë shtatzëna. Furnizimin me vaksina nuk e kemi ta caktua nëse është mujor apo javore por në momentin që na njoftojnë shkojmë dhe i marrim. Terminet janë ndërprerë prej Ministrisë së Shëndetësi për shkak se nuk ka vaksina në nivel të vendit. Sa i përket pyetjes që

ka pasur përjashtime gjatë vaksinimit, në fillim i kemi ftuar qytetarët për me u vaksinuar në mënyrë që mos me i qar dozat poshtë dhe ndoshta dikush e ka njohur dikend që ka interesim me u vaksinuar dhe e ka ftuar, ndërsa personalisht nuk e kam pasur asnjë familjarë që e kam ftuar me marr vaksinën për mos me hedhë dozë. Pacientët të cilët janë lajmëruar jemi mundur përmes listës së pritjes me i ftuar ata pacientë. Për sjellje të stafit si drejtori nuk kemi ankesa dhe për deri sa nuk kemi ankesa nuk mund të ndërmarrim asgjë. Grat shtatzëna dhe gjidhënëse duhet të vaksinohen sepse ka qenë njoftim edhe prej Ministrisë së Shëndetësisë dhe nëpër media.

Mefail Suma thekson:- kur jam dërguar me autoambulancë bombol të oksigjenit nuk ka pasur dhe në spital një mjek më ka than se kur është ardhur një i lagjes Brava z.Llokman Brava oksigjenin e kish pasur 45 dhe nuk patëm mundësi për me i ndihmuar. E di që është obligim me pasur bombol të oksigjenit në autoambulancë por duhet të na tregoni se a ka. Bombolat të cilat ishin në korridor më është vendosur njëra nuk më ka furnizuar mjaftueshëm me oksigjen por edhe tjetra nuk më ka furnizuar, ndërsa bombola e cilën më është dhënë në shtëpi më ka furnizuar mjaftueshëm dhe ju kam falënderuar që ma keni dhënë në shërbim.

Teuta Shkreta thekson:- që nga fillimi kam potencuar që të vaksinomi sa më shumë dhe tash po them që mbrohuni sa më shumë sepse jemi me një situatë që as vet nuk po e dimë se çka po ndodhë. Deri më tani vaksinat të cilat i kemi dhënë nuk kemi hasur në ndonjë problem apo me ndonjë keqkuptim në asnjë person por secili individ që hynë në QKMF duhet ta dinë që është duke hyrë me një institut shëndetësorë.

Sead Vila thekson:- qëllimi im ishte se një person nuk potencova për komplet stafin, mirëpo shpreha shqetësimin për një individ se nuk mu duk komunikimi i një motre medicinale ndaj meje dhe ndaj një pacientit të cilit i fliste me tonë të lartë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

3. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- është obligim ligjorë që të bëhet raporti gjashtë mujorë dhe përveç atyre të cilat janë paraqitur diçka të veçantë nuk kam.

Nora Xhoni thekson:- për kundër situatës me pandeminë në raport shihet që nuk kanë munguar aktivitetet dhe kontaktet me dikasteret qendrorë dhe marrëveshjet e nënshkruara. Në raportin e fundit të institutit Ri-invest lidhur me prokurimin publik për vitin 2018, 2019, 2020 ka nxjerr komunën e Hanit të Elezit si komunë me praktika dhe zbatueshmëri të Ligjit dhe e vendos si komunë të parë në Republikën e Kosovës dhe është për tu përshëndetur. Në fushën e arsimit dhe sportit në faqe 22 dhe 25 janë të bashkangjitura të gjitha aktivitetet kulturore që janë paraqitur 18 aktivitete të cilat i konsiderojmë si të suksesshme. Nëse ndahen mjete shtesë nga Qeveria e Kosovës për pandeminë drejtorja e administratës ta vendosë një aparat elektronik për nxjerrje të certifikatave të lindjes, të vendbanimit, të shtetësisë, certifikata martesore në mënyrë që të shmangen kontaktet me personat të cilët mund të jenë të infektuar. Lloje të këtyre aparaturave janë vendosur edhe në komuna të tjera në ambiente të hapura të cilat shërbejnë 24 orë. Kërkoj nga drejtorja për shëndetësi që të parashtron sa më shumë kërkesë në Ministri të Shëndetësisë që të furnizohet QKMF-ja me barna esenciale kur e dimë që është shumëfishuar buxheti në Ministri të shëndetësisë.

Habib Thaçi thekson:- çka ka ndikuar që nuk po aplikojnë për subvencione për rendimente të grurit dhe misrit kur dihet se këto rendimente janë të rëndësishme.

Rufki Suma thekson:- aplikimi bëhet kur të bëhet shpallja por në këtë vit Ministria e Bujqësisë nuk ka bërë dhe për atë është zero zero dhe drejtoria i ka paraqitur vetëm ata të cilët kanë aplikuar në komunë dhe bëhet fjalë për krahase. USAJ-di e ka shpallë prokurimin ndërsa Ri-investi e ka bërë shpërndarjen e kësaj dhe është bërë jashtë gjashtë mujorit të parë. Në raport paraqiten vetëm ajo që është punuar, ndërsa në planifikime shënohen ata të cilat mendojmë me i bërë për vitin tjetër. E-kioska për shtypjen e dokumenteve është planifikuar të bëhet në vitin 2022. Për çdo javë QKMF parashtron kërkesa në nivel qendrorë për furnizim me barna esenciale. Komuna për çdo vit ka blerë barna për QKMF. Sa i përket sjelljes së stafit në QKMF nuk përjashtohet mundësi por ata janë ndoshta individë por deri sa nuk paraqesin ankesa me shkrim nuk mund të ndërmarrim asgjë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

4. Kërkesë për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- rialokimi i dhe transferi i mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale është në shumë prej 80,068.00 €, pastaj transferi i mjeteve në kategorinë paga dhe shtesa është në shumë prej 14,000.00 €, ndërsa transferi i mjeteve nga kategoria shpenzime komunale në ate mallra dhe shërbime është në shumë prej 1,900.00 €. Pra, rialokimi dhe transferi mjeteve në total për komunën e Hanit të Elezit është në shumë prej 95,968.00 € nga fondet 10 dhe 21 sipas programeve/nën-programeve buxhetore. Në material i kemi dhënë të gjitha arsyet për rialokim dhe transfer të mjeteve.

Habib Thaçi thekson:- sa është shifra e mjeteve të cilat do të tërhiqen prej drejtorisë së arsimit sepse e dimë që jemi në pandemi e do të fillon viti shkollorë dhe këto mjete kishte qenë më mirë me i dizajnuar në procesin e arsimit për shkak se mund të kemi infektim të stafit dhe mund të kemi mungesë të stafit. Është mirë që këto mjete me mbetur në drejtori të arsimit që me pranuar staf të ri apo staf mbështetës i cili kishte me ndihmuar gjatë pandemisë për shkak se ka mësimdhënës që një muaj ka munguar.

Sead Vila thekson:- nëse është bërë analizë e mirë dhe pa nguti që këto mjete të rialokohen nga kategoritë e caktuara për projektet të cilat janë me prioritet unë do t'i përkrahë. Vitin e kaluar Ministria i ka ndarë mjetet dhe unë mendoj që është dështim i drejtorisë së arsimit që nuk e ka menaxhuar sepse mjetet janë ndarë nga Ministria vitin e kaluar për mësimdhënës të cilët mungojnë për shkak të infektimit me covid. Këtu te ne nuk ka funksionuar dhe nuk e di a ka qenë një rast në shollën fillore "Ilaz Thaçi", ndërsa shkollat tjera kanë mbetur të pa mbuluara duke pasur parasysh se sa ka qenë numri i mësimdhënësve të cilët kanë munguar në procesin mësimorë. Për këtë vit Ministria do ta mendon më mirë dhe drejtoria e arsimit ne ta përcjell siç duhet procesin dhe në ta shohë që në ato kategori ku ka mundësi për shkak të covidit dhe ato mjete që delegohen në atë kategori për me i shfrytëzuar për atë kategori sepse disa komuna i kanë shfrytëzuar mirë, kurse tek ne nuk ka shkuar mirë.

Shabi Rexhallari thekson:- rialokimi është bërë në mënyrën e duhur më të mundshme. Kategorinë e mjeteve kapitale nuk mundemi me dërguar në kategori të tjera të shpenzimeve. Shuma e mjeteve financiare në kategorinë e pagave dedikohen te shëndetësia sepse një pjesë e kemi në minus ndërsa tjetra për me i mbuluar pagat jubilarë. Mjetet të cilat janë te arsimit i kanë në shpenzime komunale dhe dedikohen në mallra dhe shërbime dhe nuk mund të dedikohen në paga. Sa i përket mundësisë së mësimdhënësve me infektuar me covid, arsimit i ka disa mjete financiare që besoj që janë të mjaftueshme dhe nuk besoj që do të ketë problem. Transferi është bërë në bazë të legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për, 2 abstenim z.Florim Shkreta, znj. Besarta Suma (nga grupi parlamentar i PDK-së) .

U MIRATUA KËRKESA PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORIN EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE

5. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- auditimi është bërë nga zyra kombëtare e auditimit të Republikës së Kosovës dhe sipas opinionit është opinion i pamodifikuar. Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. E kemi një theksim të çështjes që ka të bëjë me disa vendime gjyqësore me pagesat e disa arsimtarëve e cila është paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. I kemi dy rekomandime nga auditori, njëra ka të bëjë me tatimin në pronë që nuk është bërë verifikimi së paku 20 % i objekteve të tatimit në pronë. Për shkak të situatës me covid që ka qenë vitin e kaluar nuk kemi mundur me bërë verifikimin dhe ke kanë llogaritur si rekomandim . Rekomandimi numër dy ka të bëjë me mos funksionalizimin e sistemit epasuria pra është një sistem nga Ministria e nuk ka funksionuar një vit e më shumë dhe e kanë dhënë si rekomandim. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

Sead Vila thekson:- regjistrimet që janë bërë nëpër gjitha institucionet janë dhënë rekomandime që jo vetëm si regjistrime të jen por të jenë edhe me barkode dhe me kosto financiare e pasi është bërë edhe me pjesën e dytë a është kthyer përgjigje pozitive që institucionet kanë bërë një auditim në rregull sidomos për institucion shkollorë më intereson që ta dijë.

Habib Thaçi thekson:- nëse është auditim i jashtëm prej Qeverisë mendojë që është bërë një punë e mirë sepse janë dhënë vetëm dy rekomandime shumë reale dhe ka qenë pandemi e ndoshta nuk kanë mundur me u realizuar.

Shabi Rexhallari thekson:- është auditim i përgjithshëm , ndërsa te rekomandimet që u parashtruan nga parafolësit e di që është regjistrimi i inventarit nëpër shkolla, pastaj ata të cilat i keni regjistruar ju është dashur me i regjistruar në sistemin epasuria për me u bërë zhvlerësimi por sistemi nuk ka funksionuar dhe kemi mbetur pa i kryer dhe duhet të bëhen në formë tjetër në eksell.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

6. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- materialin është përcjell me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

7. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020-2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në informatë drejtori i ka paraqitur në detale të gjitha të dhënat, nëse keni ndonjë pyetje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

8. Informatë për korrije shirjet.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- në material janë të paraqitura të gjitha të dhënat sa i përket korrije shirjeve. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- duhet t'i parashtrohet kërkesë me shkrim OJQ "Labi" që t'i siguron kombajet me qëllim të aritjes së nxitjes së bujqve për me mbjell për vitet e tjera.

Habib Thaçi thekson:- të njëjtin propozim e kam edhe unë sikur parafolësja për me i subvencionuar me disa traktorë që i kanë disa kombaja të vogël dhe mos të ndahen vetëm me një kategori por të ndahet në kategorinë që ka më së shumti nevojë.

Zaim Bela thekson:- këtë çështje nuk e kemi diskutuar por OJQ "Labi" e ka programin për me krijuar biznese që me punësuar dikend. Gjatë takimeve që do të i kemi do ta diskutojë këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

9. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 12:01.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

